

Komentet e pjesemarrësve ne keshillimin publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, 2110-2170 MHz, brezi - UMTS”

Në zbatim të shkronjes g) dhe gj) te nenit 8, te nenit 65, te nenit 68, të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*), dhe Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP-it Nr.1958, datë 24.05.2012 Për “Miratimin e dokumentit për keshillim publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz, brezi - UMTS”, AKEP kreu nje keshillim publik.

Ne perfudim te ketij keshillimi publik ne AKEP u depozituan kater komente nga pale te interesuara.

Me poshte paraqiten komentet e te interesuarve dhe qendrimi perkates i AKEP.

OPERATORI 1

Lancimi i sherbimeve 3G, te cilat perdorin brezin e frekuencave 3G, ka permiresuar ndjeshem komunikimin dhe eshte rritur cilesia e sherbimeve. Aksesit ne internet me shpejtesi me te madhe nepermjet aparateve celulare ka rritur me tej mundesine per perdorimin e internetit dhe ne zona me te thella ne te cilat perdorimi i internetit ka qene thuajse i pamundur.

Licensimi i dy operatoreve te pare ne Shqiperi ne brezin e frekuencave UMTS ka rezultuar i suksesshem dhe konkurrenca eshte rritur ndjeshem pas dhenies se licenses se dyte 3G, duke evituar nje situatë monopoli me nje operator te vetem.

Konkurrenca ka nxitur te dy operatoret qe te rrisin gamen e sherbimeve dhe paketave tarifore per abonentet perkates, nepermjet tarifave sa me te arsyeshme per konsumatorin.

Planifikimi per dhenien e dy licensave te tjera 3G do te rri si pranine e operatoreve te tjere ne treg, duke rritur konkurrencen midis tyre dhe do te sjelle perfitime te metejshme per abonentet me cmime me te leverdisshme per konsumatoret dhe nje game me te gjere te sherbimeve qe do te ofrohen sipas nevojave te tyre.

Pyetje nr.1

A jeni dakort me kete ndarje te brezave? Po me sasine e spektrit per cdo te drejte perdorimi?

Ne lidhje me ndarjen e brezave sic permendet ne dokument per dy licensat 3G: 2x 15 MHz spekter i ciftuar dhe 5 MHz spekter i paciftuar, duhet te jete ne te njejten linje me ndarjen e brezave per dy licensat e para 3G, si dhe me praktiken e ndjekur ne shumicen e vendeve te tjera te rajonit dhe te BE-se.

Duke iu referuar dy licensave te para 3G, ndarja e brezave ka te njejten skeme: 2 x 15 MHz spekter i ciftuar me 1 x 5 MHz spekter i paciftuar OPERATORI 1 eshte dakort me ndarjen e frekuencave sipas skemes se propozuar nga AKEP: 2x15 MHz spekter i ciftuar dhe 5 MHz spekter i paciftuar.

Qendrimi i AKEP:

OPERATORI 1 eshte dakort me ndarjen e brezave dhe sasine e spektrit per cdo te drejte perdorimi te propozuar nga AKEP.

Pyetje Nr.2

Mendoni se do te jete me e pershtatshme te jepet nje e drejte perdorimi apo dy te drejta perdorimi ne te njejten kohe?

Dhenia e dy te drejtave te perdorimit ne dy faza te ndryshme ose ne te njejten kohe varet nga disa faktore, si p.sh. procesi i ndjekur deri tani, trajtimi ne menyre te barabarte i operatoreve ne treg, etj. Duke qene se te gjithë operatorët celularë kanë marrë pjesë në tre tenderet e pare publike të zhvilluar për licensat 3G, OPERATORI 1 beson që dy operatorët e tjere janë të interesuar për marrjen e licensave 3G. Te dy operatorët kanë kohe që janë aktive në tregun shqiptar të komunikimeve elektronike dhe kanë krijuar bazen e perhershme të abonenteve të tyre, të ardhurat e tyre janë rritur ndjeshëm gjatë kësaj periudhe kohore, bashkë me gamën e shërbimeve që ofrojnë. Meqenëse dheniet e dy licensave të para 3G janë dhënë në menyre sekuenciale, e njëjta procedurë duhet të ndiqet dhe për dhenien e dy licensave të tjera 3G të planifikuara nga AKEP. Dhenia e një te drejte perdorimi duhet të bëhet nëpërmjet procedurës së tenderimit, gjithashtu të lihet një kohe e nevojshme midis dhenies së dy licensave, sic është bërë dhe në rastin e leshimit të autorizimeve 3G të para.

Duke ndjekur të njëjten procedurë nga AKEP për dhenien e te drejtave të perdorimit në frekuencat UMTS, i vendos operatorët në të njëjtat kushte konkurruese në treg.

Dhenia e dy licensave të tjera 3G në të njëjten kohe do të krijonte pozita diskriminuese midis operatoreve. Në respekt të parimit të mosdiskriminimit, dhenia e licensave të tjeeter 3G duhet të marrë në konsideratë investimin e bërë dhe kohën e nevojshme për hedhjen në treg të shërbimeve 3G, dhe dhenia e vetëm një te drejte perdorimi me anë të procesit të tenderimit sic është vepruar deri tani do të ishte menyra e duhur për t'u ndjekur nga AKEP.

OPERATORI 1 nuk është aspak dakort me dhenien e te drejtave të perdorimit në të njëjten kohe për të dy operatorët e tjere.

Qendrimi i AKEP:

Intervali kohor i dhenies së te drejtave të perdorimit është i njëjte me intervalin kohor të aplikuar deri tani nga AKEP për dy autorizimet e para.

Dhenien e dy te drejtave të perdorimit në të njëjten kohe AKEP e sheh si një mundësi për:

- **te rritur konkurrencen në treg;**
- **shfrytëzimin sa më efikas të brezave të frekuencave UMTS;**
- **shtrirjen e shërbimeve broadband me shpejtesi në të gjithë territorin e vendit;**
- **permbushjen e interesave publike me shërbime të mbështetura në keto breza;**
- **hapjen e tregut të komunikimeve elektronike për investime të reja.**

Pyetje nr.3

AKEP mendon që vlefshmeria e nje Autorizimi të leshuar të jete 15 vjet.

Licensat 3G në shumë vende në rajon dhe në vende të tjera të BE-së kanë një vlefshmeri të kohezgjatjes mesatare të tyre prej 15 vjetësh. Dhe dy licensat e para 3G në vendin tone të dhëna kanë të njëjten kohezgjatje prej 15 vjetësh.

OPERATORI 1 është dakort që vlefshmeria e autorizimit të leshuar të jete 15 vjet dhe për dy licensat e tjera 3G që do të jepen nga AKEP.

Qendrimi i AKEP:

OPERATORI 1 është dakort me propozimin e AKEP për kohezgjatjen e vlefshmerisë së autorizimit prej 15 vjetësh.

Pyetje nr.4

Cila është vlera që jeni të gatshëm të paguani për Autorizim sipas përcaktimit të bërë në piken

1.2 të këtij dokumenti?

Frekuencat janë një burim natyror i fundem sipas nenit 62 të ligjit nr.9918, pra një pasuri publike, dhe konsiderohen si aset jo material që fitojnë një vlerë të matshme sa herë që jepen në përdorim për qëllime komerciale ose publike. Me to janë të lidhura ngushtë një sërë aktivitetesh ekonomike dhe komerciale në sektorin e komunikimeve elektronike të cilat gjenerojnë të ardhura të konsiderueshme për ekonominë e një vendi. Prandaj, dhënia në përdorim e frekuencave bazohet përkrah të karakteristikave fundamentale si burim i kufizuar me natyrë publike, dhe vlera ekonomike e tyre reflekton rëndësinë e madhe të spektrit dhe përcaktimi i kësaj vlerë i shërben objektivit të përdorimit sa më eficient të spektrit të frekuencave nga paletë e interesuara.

Vlera ekonomike e spektrit përfitohet nga fitimet që një operator shërbimesh mund të përfitojë nga ofrimi i aplikimeve dhe shërbimeve me vlerë duke përdorur ekskluzivisht këto frekuenca. Çmimi i përcaktuar për dhënie në përdorim të spektrit të frekuencave pasqyron vlerën ekonomike të spektrit dhe është një element i rëndësishëm për buxhetin e shtetit, i cili i paguhet AKEP kundrejt dhënies së licensave operatorëve përkatës. Gjithashtu, shteti përfiton të ardhura të konsiderueshme, jo vetëm nga çmimi për frekuencat që paguajnë operatorët, por dhe nga aktiviteti komercial që ushtrojnë këta operatorë të lidhur me përdorimin e frekuencave nëpërmjet detyrimeve përkatëse. Përcaktimi i vlerës ekonomike të spektrit të frekuencave, dhe për rrjedhojë, të çmimit të tij, varet nga një seri faktorësh siç janë:

- a) E drejta e përdorimit të frekuencave: kohezgjatja e të drejtës së përdorimit, kriteret për mbulimin e territorit, etj;
- b) Kriteret teknike për përdorimin e frekuencave: dimensionet dhe brezët e disponueshëm të frekuencave, teknologjitë përkatëse për shërbimet për të cilat behet aplikimi, kushtet teknike për bashkëzistencën me shërbimet e afërta me to;
- c) Karakteristikat e frekuencave: - karakteristikat e përhapjes së një brezi specifik frekuencash - çdo frekuencë ka karakteristikat e saj që shpjegojnë gamën e aplikimeve që përdorin spektrin dhe përshtatshmeria e frekuencave specifike për aplikime të vecanta;
- d) Niveli i konkurrencës në treg;
- e) Kërkesa për shërbimet: Sa më e madhe të jetë kërkesa për shërbimet në tregun me pakicë, aq më eficient do të jetë përdorimi i spektrit. Kur kërkesa për shërbimet në tregun me pakicë është e lartë, aq më shumë vlerë është spektri për poseduesin.

Në përmbledhje, vlera për dhënie të frekuencave varet nga shërbimet që mund të ofrohen në lidhje me këto të drejta përdorimi, si dhe nga pritshmëritë e kompanive në lidhje me zhvillimet e ardhshme në treg dhe fitimi. Frekuencat UMTS janë një burim i fundem dhe gjenerojnë një tjetër burim fitimi dhe shërbime me vlerë për operatorin që do të marrë këto të drejta përdorimi.

Gjithashtu, në respekt të parimit të mos-diskriminimit, AKEP duhet të vendosë operatorët në treg në të njëjtat kushte dhe detyrime, duke u dhënë të shanse të njëjta për të konkurruar në

treg dhe te marre ne konsiderate disa faktore: kushtet akluale tregut shqiptar te telefonise celulare, suksesi i sherbimeve 3G dhe kerkesa ne rritje per keto sherbime ne tregun me pak ice, dhe fakti qe kuotat e tregut ne terma te te ardhurave dhe te abonenteve te dy operatoreve kandidatet jane rritur.

Qendrimi i AKEP:

AKEP, duke vleresuar ecurine e deritanishme te procesit te dhenies se te drejtave te perdorimit ne brezat UMTS si:

- **dhenien e dy autorizimeve te mëparshëm individuale për përdorimin e frekuencave të brezit 1920.3-1935.3/2110.3-2125.3 MHz dhe 1900.0-1905.0 MHz sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.a. me vlere 31.400.000 Euro, dhe brezit 1935,3-1950,/ 2125,3 – 2140,1 MHz dhe 1905-1910 MHz sipërmarrësit Albanian Mobile Communications Sh.a. me vlere 15.100.000 Euro, nëpërmjet zbatimit të procedurës së tenderit publik.**
- **ofertat e paraqitura ne proceduren per dhenien e te drejtes se trete te perdorimit ne keto breza frekuencash**
- **analizen e tregut te komunikimeve elektronike ne lidhje me shtrirjen dhe tarifat per sherbimet e standardit 3G;**
- **duke marre ne konsiderate edhe propozimet e ardhura ne kete keshillim publik**

propozon nje cmim minimal te pranimit te ofertes ne vleren 4.000.000 (katërmilion) Euro.

Pyetje nr.5

A ka ndonje ceshtje tjeter per t'u marre ne konsiderate ne kete proces?

Gjithashtu OPERATORI 1 eshte dakort me vendosjen e kushteve te njejta obliguese per nivelin dhe kohen e arrijtes se mbulimit me sinjal UMTS, qe eshte mblimi prej 85% te territorit brenda nje periudhe 18 mujore. Kjo do te shmangte diskriminimin perkates me kushtet e dhenies se dy licensave te para.

Qendrimi i AKEP:

OPERATORI 1 eshte dakort me propozimin e AKEP per kushtet e mbulimit.

OPERATORI 2:

Operatori 2, ne vijim te VKD nr. 1958 date 24.05.2012 Per "Miratimin e dokumentit per keshillim publik "Mbi dhenien e te drejtave te perdorimit ne brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz, brezi - UMTS", paraqet komentet e saj si me poshte vijon;

• Per te siguruar barazine e trajtimit te te gjithë kompanive ne treg dhe investimeve te huaja, AKEP nuk duhet te ofroje frekuencat per teknologjine 3Gne kushte me te favorshme se ato qe ju a ka ofruar operatoreve ekzistues

Operatori 2 pershendet synimin paresor te Qeverise per dhenien e te drejtave te perdorimit per frekuenca. Sidoqofte procesi duhet te udhehiqet jo vetem nga parimet e objektivitetit dhe transparences, por edhe te mosdiskriminimit. Vetem ne nje treg te balancuar, ku te gjithë lojtarët ne treg trajtohen ne menyre te barabarte, mund te arrihet konkurrence plote dhe efektive e cila garanton produkte perfundimtare me te mira per konsumatorët. Me mosdiskriminim, ne kete rast, ne kuptojme qe AKEP nuk duhet te ofroje frekuencat e mbetura per perdorim ne kushte me te favorshme, se ia ka ofruar operatoreve qe tashme i zoterojne keto frekuenca. Nese ofrohet nje procedure me lehtesuese apo nje cmim me i ulet fillestar sesa ne procedurat paraardhese per frekuencat UMTS, kjo i vendos operatoret ekzistues qe operojne ne teknologjine 3G ne pozite me te disfavorshme ekonomike dhe shtremberon konkurrencen e ndershme. Parimi i mosdiskriminimit eshte thelbesor ne aktivitetin e AKEP (Ligji 9918, neni 7) dhe qartesisht i sanksionuar per zbatim pergjate procedures se tenderit per caktimin dhe perdorimin e frekuencave (Ligji 9918, neni 69). Keto parime permenden dhe ne Direktiven Kuader 2002/21 EC neni 9/1 ku percaktohet se "shtetet anetare duhet te bejne alokimin e frekuencave ne baza objektive, transparente, jo-diskriminuese dhe ne menyre proporcionale."

Ne tenderat pararendes, te gjithë operatoret pjesemarres kane qene te barabarte per te dhene oferten e tyre, ne kushte te njejta, perfshire edhe ata operatore qe garojne serish sot si pale te interesuara per brezin e frekuencave. Ndaj dhe cdo ndryshim nga kushtet fillestare, sidomos cmimi minimal, ne kete faze kur dy prej operatoreve nuk garojne me, por kane paguar shuma te medha per marrjen ne perdorim te frekuencave per breza te ngjashem, do te vinte ne kundërshtim me parimin e barazise dhe mosdiskriminimit ne nje treg te lire konkurrues.

• Konkluzion: Per te siguruar barazine e trajtimit te te gjithë kompanive te treg dhe investimeve te huaja, AKEP nuk duhet te ofroje frekuencat per teknologjine 3G ne kushte me te favorshme se ato qe ju a ka ofruar operatoreve ekzistues

• Qeveria shqiptare dhe AKEP duhet te organizojne nje tender te hapur me kriteret e njejta vleresimi si ato te aplikuar ne tenderat e meparshem, ne perputhje me parashikimet e VKM nr. 1252 dhe percaktimeve te Ligjit nr. 9918 per rastin konkret.

Sipas qasjes procedurale ne lidhje me kete ceshtje, Operatori 2 konsideron se hapat e meposhtem jane te detyrueshem per t'u ndjekur sipas Ligjit nr. 9918, date 18,05,2008 "Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise" dhe VKM nr, 1252, e dates 10,09.2008

(ndryshuar):

• AKEP eshte shprehur se kerkesa e paleve per autorizime tejkalon spektrin e disponueshem (d,m,th, me shume se kater kerkesa per kater autorizimet e disponueshme), Ne keto kushte dhe ne zbatim te pikes 1.4 te VKM nr, 1252, AKEP duhet te zbatoje proceduren e hapur te tenderit publik pas miratimit te Ministrit. E njejta procedure eshte ndjekur edhe gjate tenderave publik pararendes per breza te ngjashem te frekuencave UMTS,

• Me qellim qe te garantohet barazia dhe mosdiskriminimi midis operatoreve ne treg, AKEP duhet te vendose te njejtat kushte: oferte fillestare dhe kriteret teknike

te njejta si ne rastin e tenderave te meparshem sic edhe parashikon VKM nr. 1252. Procedura mbi te gjitha duhet te jete transparente. objektive. jo-diskriminuese dhe e barabarte. Kjo eshte teper e rendesishme edhe per te garantuar barazine e mosdiskriminimin e investimeve te huaja ne Shqiperi ne raport me investimet vendase, si dhe trajtim te barabarte te investitoreve te huaj pavaresisht origjines.

• Qeveria shqiptare se bashku me AKEP duhet te angazhohet per promovimin e sherbimeve qe shfrytezojne teknologjine 3G, me qellim nxitjen e perdorimit te teknologjise ne mase te gjere dhe ndihmese per rikuperimin e investimeve nga operatoret e rrjeteve.

Operatori 2 eshte i mendimit se AKEP ne bashkepunim me Qeverine Shqiptare duhet te punojne me tej per te zhvilluar mundesite per te nxitur kerkesen per sherbimin 3G. Sipas studimeve ne BE, nje tjetër faktor shume i rendesishem per percaktimin nese sherbimet UMTS ne treg do te behen sherbime masive jane masat nxitese te kerkeses qe Qeveria e nje vendi duhet te marre per te nxitur institucionet qeveritare, aktoret ekonomike dhe publikun per te perdorur keto sherbime te reja, Pra, permasa dhe shpejtesia e masave per stimulimin e kerkeses per sherbime te tilla qe Qeveria Shqiptare do te zbatoje, si p.sh, e-health, e-economy, e-commerce, etj, do te ndikojne ne faktin nese dhe kur sherbimet UMTS, sherbimet e levizshme me brez te gjere do te behen sherbime masive ne Shqiperi. Kjo per faktin se rritja e penetrimit te sherbimeve te tilla varet nga shkalla e dixhitalizimit te ekonomise dhe shkembimeve ekonomike dhe sociale ne pergjithesi. Elemente te tjere te qe ne menyre indirekte stimulojne kerkesen kane te bejne me disponueshmerine ne mase te kompjuterave, smartphones, softwares perkates, dhe pajisjeve te tjera High Tech me cmime te perballueshme per publikun, lehtesim fiskal, apo zgjidhje te tjera te cilat duhet te trajtohen nga Qeveria dhe nga aktoret perkates te industrise se Teknologjise se Informacionit. Nese te gjithë faktoret e mesiperm nderveprojne sic duhet, Operatori 2 mendon se ka mundesi te mira qe sherbimet celulare me brez te gjere te rriten gradualisht ne vitet ne vijim, Kerkesa ne rritje dhe masa e gjere e ofrimit te sherbimit do te garantoje jetegjatesine dhe cilesine tij, Ne permbledhje te sa me siper, konkludojme se te gjitha strategjite dhe planet e Qeverise dhe AKEP per nxitjen e sherbimeve broadband jane shume te rendesishme, do te sillnin rritjen e kerkeses per sherbimet broadband dhe do te ndihmonin operatoret e rrjeteve per rikuperimin e ketyre investimeve, prandaj Operatori 2 i pershendet dhe mbeshtet keto strategji dhe plane te Qeverise dhe AKEP.

Pyetja 1:

A jeni dakord me kete ndarje te brezave? Po me sasine e spektrit per cdo te drejte perdorimi?

Operatori 2 shprehet se masa e spektrit eshte e njejte (3xFDD carriers +1 xTDD carrier) me ate qe i'u eshte alokuar operatorëve te tjere pararendes ne tenderat e meparshem per dhenien ne perdorim te frekuencave per teknologjine UMTS, ndaj dhe shprehet dakord me kete ndarje brezash, si dhe sasine e spektrit te propozuar per perdorim.

Qendrimi i AKEP:

Operatori 2 eshte dakort me ndarjen e brezave dhe sasine e spektrit per cdo te drejte perdorimi te propozuar nga AKEP.

Pyetja 2:

Mendoni se do te jete me e pershtatshme te jepet nje e drejte perdorimi apo dy te drejta perdorimi ne te njejten kohe?

Operatori 2 shprehet i mendimit se AKEP e ka bere tanime zgjedhjen per dhenien e te drejtave te perdorimit. duke i leshuar ate njera pas tjetres ne periudha te shkeputura kohore. Dhe duke garantuar keshtu nje periudhe dritare te ndermjetme e cila ofron siguri per operatoret pararendes ge kane paguar tanime per Autorizimet e marra me pare ne kohe. Kjo pervecse garanton trajtim te barabarte mes te gjithe operatoreve. ndihmon operatoret ekzistues qe te kene kohe te mjaftueshme per te realizuar rikuperimin e investimit. Cdo ndryshim i paparashikuar i modelit te tenderimit te frekuencave do te shkaktonte luhatje serioze ne planet e biznesit te sipermarresve, te cilet kane investuar shuma te konsiderueshme jo vetem ne blerjen e Autorizimeve. por edhe ne ngritjen e rrjetit qe mundeson sherbime UMTS.

Konkluzion: Operatori 2 shprehet se AKEP duhet te vazhdoje te aplikoje proceduren e ndjekur deri me tani per dhenien e autorizimeve; AKEP duhet t'i jape autorizimet njeri pas tjetrit me nje periudhe kohore te ndermjetme. sic edhe ka vepruar ne rastin e dy autorizimeve fillestare.

Qendrimi i AKEP:

Intervali i kohes per dhenien e te drejtave te perdorimit perputhet me strategjine e ndjekur nga AKEP deri tani edhe per dhenien e dy autorizimeve te para. Dhenien e dy te drejtave te perdorimit ne te njejten kohe AKEP e sheh si nje mundesi per:

- **te rritur konkurencen ne treg, per**
- **shfrytezimin sa me efikas te brezave te frekuencave UMTS, per**
- **shtrirjen e sherbimeve broadband me shpejtesi ne te gjithe territorin e vendit, per**
- **permbushjen e interest publik me sherbime te ofruara ne keto breza, per**
- **hapjen e tregut te komunikimeve elektronike per investime te reja**
- **dhe duke shfrytezuuar eksperiencen me te mire te vendeve te tjera europiane.**

Pyetja 3:

Cila eshte vlera qe jeni te gatshem te paguani per Autorizim sipas percaktimit te bere ne piken 1.2 te ketij dokumenti?

Operatori 2 i kerkon AKEP qe vlera e ofertes fillestare per Autorizimin e rradhes te jete 12.5 milion Euro aq sa ka qene dhe ne dy tenderat e meparshem per dhenien ne perdorim te frekuencave per teknologjine UMTS. Vetem ne kete menyre Qeveria shqiptare dhe AKEP do mund te respektojne maksimalisht parimin e mosdiskriminimit dhe do te shmangnin favorizimin arbitrar ne terma financiare, nga i cili do te perfitonin operatoret e mbetur per te marre ne perdorim brezin e frekuencave. Edhe autorizimi i trete dhe i katert qe planifikohen te leshohen jane te vlefshem per nje periudhe prej 15 vjet dhe eshte mese i sigurt kthimi i vleres se investimit (return on investment - ROI).

Nga ana tjetere, operatoret qe hyne i treti dhe i katerti ne treg kane pasur mundesine te ngrene rrjetin me teknologjine me te fundit. duke pasur keshtu nje avantazh konkurrues persa i perket pershtatjes se rrjetit ekzistues me teknologjine 3G.

Gjithashtu, cka eshte dhe me e rendesishmja. Qeveria dhe AKEP duhet te mbajne ne vemendje qe cdo trajtim favorizues ndaj ketyre dy operatoreve, duke u dhene nje cmim

fillestar nen 12.5 milion Euro, do t'i vendoste ata ne nje avantazh te theksuar financiar per ngritjen e rrjetit ndaj dy operatoreve qe tashme i ka paguar keto autorizime ne vlera me te larta dhe do te minonte konkurrencen e ndershme ne treg.

Konkluzion: AKEP duhet te vendose nje vlere fillestare minimale ne kuoten e 12.5 milione Euro per Autorizimin e 3te dhe me pas per Autorizimin e 4t, sic edhe ka vepruar me vleren fillestare ne tenderin publik pararendes per frekuencat UMTS.

Qendrimi i AKEP:

AKEP, duke vleresuar ecurine e deritanishme te procesit te dhenies se te drejtave te perdorimit ne brezat UMTS:

- **dhenien e dy autorizimeve te mëparshëm individual për përdorimin e frekuencave të brezit 1920.3-1935.3/2110.3-2125.3 MHz dhe 1900.0-1905.0 MHz sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.a. me vlere 31.400.000 Euro, dhe brezit 1935,3-1950,/ 2125,3 – 2140,1 MHz dhe 1905-1910 MHz sipermarresit Albanian Mobile Communications Sh.a. me vlere 15.100.000 Euro, nëpërmjet zbatimit të procedurës së tenderit publik.**
- **Ofertat e paraqitura ne proceduren per dhenien e te drejtes se trete te perdorimit ne keto breza frekuencash**
- **gjendjen e tregut aktual te komunikimeve elektronike**
- **duke marre ne konsiderate edhe propozimet e ardhura ne kete keshillim publik**

do te propozoje nje cmim minimal te pranimit te ofertes me vlere prej 4.000.000 (katërmilion) Euro.

Pyetja 4:

AKEP fton sipermarresit te shprehen ne Lidhje me kriteret e mbulimit me sherbim ne shkalle gjeografike.

Operatori 2 shprehet se persa kohe keto kriteret teknike jane te njejta me kriteret e aplikuar ne leshimin e dy autorizimeve te meparshme. atehere ate jane te drejta dhe te pranueshme. Ne kete kuader. ne shprehemi dakord me propozimin e AKEP per fazat e mbulimit te territorit dhe shtrirjen perkatese ne kohe.

Qendrimi i AKEP:

Operatori 2 eshte dakort me propozimin e AKEP per kushtet e mbulimit.

Pyetja 5:

Aka ndonje ceshtje tjeter per t'u marre ne konsiderate ne kete proces?

Operatori 2 sheh si te nje rendesi themelore per shtrirjen e rrjetit me brez te gjere ne te gjithe Shqiperine. Paralelisht me dhenien ne perdorim te frekuencave radio, dhe shtrirja e lidhjes me fiber per rrjetin backbone. Per kete arsye, ne mendojme se AKEP dhe Qeveria shqiptare. Ne linje me strategjine dhe deklaratat e Politikës per komunikimet elektronike duhet te vijojne me hapat konkrete ne percaktimin e kuadrit Ligjor dhe rregullator per

implementimin e rrjetit kryesor te fibres (fiber backbone network). Per te permbushur misionin e tyre per shtrirjen e ekonomise dixhitale duke garantuar mundesi te barabarta dhe te hapura per te gjitha palet qe duan te kryejne investime.

Qendrimi i AKEP:

Vleresojme komentin e Operatori 2.

OPERATORI 3

Operatori 3 mirepriti ftesen e AKEP ne lidhje me dergimin e komenteve per dokumentin per Keshillim Publik "Mbi dhenien ne perdorim te brezave te frekuencave UMTS 1900-1980 MHz dhe 2110-2170 MHz", Me poshte ju dergojme qendrimin e Operatori 3 mbi pyetjet e parashtruara ne kete dokument.

Pyetja 1: A jeni dakort me kete ndarje te brezave? Po me sasine e spektrit per cdo te drejte perdorimi?

Bashkohemi me konsideratat e AKEP lidhur me ndarjen e brezave dhe sasine e spektrit per te drejtat e perdorimit

Qendrimi i AKEP:

Operatori 3 eshte dakort me ndarjen e brezave dhe sasine e spektrit per cdo te drejte perdorimi te propozuar nga AKEP.

Pyetja 2: Mendoni se do te jete me e pershtateshme te jepet nje e drejte perdorimi apo dy te drejta perdorimi ne te njejten kohe ? Ju lutemi komentin Tuaj.

Mendojme se te dy te drejtat e perdorimit duhet te jepen ne te njejten kohe sipas parimit kush kerkon i pari, sherbehet i pari.

Qendrimi i AKEP:

AKEP eshte dakort me propozimin e Operatori 3.

Pyetja 3: Cila eshte vlere qe jeni te gatshem te paguani per Autorizim sipas percaktimit te bere ne piken 1.2 te ketij dokumenti?

Qendrimi i Operatorit 3 ne lidhje me pyetjen me siper eshte per dhenien pa pagese te Autorizimit per perdorimin e frekuencave UMTS. Per Operatorin 3, ky qendrim argumentohet me poshte si rezultat i shqyrtimit te faktoreve te ndryshem qe jane percaktues per vleresimin qe nje kompani eshte e gatshme te jape per nje vlere konkrete per marrjen e ketij Autorizimi. Keshtu, mes faktoreve te tjere, duhen konsideruar:

Koha e dhenies se autorizimeve -Autorizimet 3G jane dhene ne shume shtete te Europes ne vitet 2000 - 2002 dhe cmimet e larta te dhenies se autorizimeve jane justifikuar edhe nga koha e dhenies se ketyre autorizimeve. Me kalimin e viteve vliera e dhenies se ketyre

Autorizimeve ka ardhur gjithmone ne renie, dhe kjo tendence eshte mjaft e theksuar ne vitet e fundit. Kjo per shkak edhe te pamundesise per marrjen e kthimeve nga ky investimi nen driten edhe te zhvillimeve te teknologjive te reja. Edhe ne Shqiperi Autorizimi i pare u dha ne vleren prej 31.400.000 euro dhe menjehere nje vit me pas u vu re renia e vleres se tregut ne 15.100.000 euro, cfare deshmon qarte prirjen, interesin apo ngopjen e tregut per ofrimin e sherbimeve 3G.

Zevendesimi me teknologji te reja ne treg. Teknologjia 3G ka filluar te perdoret ne shume vende te Europes qe prej viteve 2000-2002. Presupozohet se ne te ardhmen jo te larget kjo teknologji do te zevendesohet nga teknologji te reja si 4G, 5G (konkretisht eshte 4G aplikohet ne shtete si Japoni, SHBA etj). Si pasoje vlera e autorizimeve per shkak te zevendesimit te tyre me teknologji me te reja eshte ne renie. Operatori 3 kerkon te pajiset me Autorizimin per perdorimin e teknologjise 3G dhe ne prespektiven e teknologjive te reja do te vleresoje me pas nese perben rast biznesi dhe mundet qe nese sherbimet 3G te ofruara nga Operatori 3 nuk do gjejne vend ne treg apo qe kthimi nuk do justifikojte investimet e nevojshme, Operatori 3 do detyrohet te ndermarre hapat e nevojshem per t'iu pergjigjur prirjeve globale te perdorimit te spektrit.

Konkurrenca ne treg - Autorizimet jane dhene ne gmime te larta ne rast se ka pasur konkurrenca ne treg, domethene jane ofruar me pak te drejta perdorimi sesa operatore te interesuar per keto ligenca ne treg.

Nderkohe, aktualisht AKEP propozon dhenien e dy te drejtave te perdorimit te spektrit UMTS. Ne tregun aktual te komunikimeve elektronike, bazuar edhe ne progedurat e meparshme te tenderave publike per dhenien e licencave 3G, numri i operatoreve te interesuar per te marre kete Autorizim eshte vetem 2 operatore, ne kushtet kur ne nje vend si Shqiperia ku per siperfaqe terri tori te vogel dhe mbi te gjitha per numer popullsie qe nuk i kalojne 4 milion banore operojne 4 operatore celulare, dy prej te cileve tashme gezojne Autorizimet per frekuencat UMTS, siuate e cila deshmon se ka shume pak vend per te hyre ne treg sukseshem dhe per me teper eshte teper e veshtire te mund te marresh kthimin per cfare do lloj pagese qe operatori mund te ofroje per kete Autorizim. Nderkohe, pervoja e meparshme ka treguar se operoret te cilet kane hyre me pare ne treg kane arritur te ruajne dominance e tyre edhe pas hyrjes se operatoreve te rinj.

Ofrim i sherbimit te Internetit nga Operatori 3 me tarife te ulet per abonentet. Operatori 3 ka qene nder operoret e pare celular qe ka ofruar per abonentet e vet sherbimin e internetit tarifa shume te lira. Ky sherbim vazhdon tu ofrohet me sukses abonenteve, ne nje cilesi te mire dhe me tarifa te uleta. Duke qene sherbim ekzistues (pavaresisht ne shpejtesi me te ulet se sherbimi 3G, por gjithsesi me shpejtesi te kenaqshme per abonentin), per arsye edhe te faktoreve te permendur me siper, nuk eshte ne interesin e kompanise te ofroje nje vlere te caktuar per marrjen e ketij autorizimi si edhe ta ofroje ne treg me cmim te larte per abonentet, te cilet per shkak te koston gjithsesi do te zgjidhnin internetin ekzistues i cili ka nje tarife me te ulet dhe cilesi te mire. Operatori 3 synon te ruaje politikat e tarifave racionale per abonentin ndaj dhe nuk mund te rrise koston e saj per ofrimin e sherbimeve.

Kushtet aktuale te tregut te telefonise celulare ne Shqiperi- nese shohim tregun e aktual te komunikimeve elektronike ne Shqiperi, shohim se zhvillimi i hyresve te rinj eshte mjaft i veshtire, marre parasysh te gjithe treguesit e tregut te komunikimeve elektronike. Konkretisht, veme re se Operatori 3 ka renie te pjeseve te tij te tregut dhe renie te te ardhurave. Krahasuar me vitet e meparshme te dhenies se Autorizimeve Individuale, (2010 dhe 2011), Operatori 3 nuk e sheh ne te njejten optike pagesen per marrjen e ketij Autorizimi si dhe vleren aktuale te ketij autorizimi ne treg. Operatori 3 mori pjese ne prokurimet publike te zhvilluara nga AKEP ne vitin 2010 dhe 2011 duke ofruar nje vlere te caktuar per blerjen e autorizimeve 3G, marre parasysh plan biznesin e kompanise per rritjen e te ardhurave dhe numrit te abonenteve te vet, ne nje treg me konkurrenca efektive. Por, keto parashikime nuk

jane realizuar dhe situata ne tregun aktual te komunikimeve elektronike nuk e justifikon pagesen per kete autorizim.

Konkretisht eshte mjaft i veshtire kompensimi i kostove te implementimit te ketij sherbimi per operatorin, marre parasysh faktore te tille si:

- numer i ulet aktual i abonenteve aktive te Operatori 3; ulje e pjeseve te tregut dhe te ardhurave te Operatori 3. Penetrimi i tregut me rreth 185% tregon pamundesine e rritjes se metejshme te pjeseve te tregut; Ne shume vende te botes vihet re lidhja e drejtperdrejte e cmimit te shitjes te autorizimit 3G nga shteti, me numrin e perdoruesve te ketij sherbimi, ku logjikisht nese numri i perdoruesve eshte i larte, edhe ,cmimi i blerjes do ti rikthehet operatorit nga pagesat e perdoruesve te sherbimit.

- Shqiperia ka te ardhura te uleta per fryme (GDP per person), rrjedhimisht pak mundesi per perdorimin e sherbimeve me kosto te larte. Sherbimet 3G jane shitur me ,cmimet me te larta ne vitin 2000 ne Gjermani dhe Angli. Cmimi i larte i shitjes se tyre ka ardhur direkt si rezultat i ekonomise se larte te ketyre vendeve dhe GDP per person si dhe kohes se ofrimit te ketyre sherbimeve, 12 vjet me pare, sic e shtjelluam me lart.

Gjithashtu, eshte vene re perdorim i ulet i sherbimeve 3G nga abonentet shqiptare deri me tani, per arsye te koston se larte te ketij sherbimi per abonentin, krahasuar me te ardhurat e tij, nderkohe abonentet e Operatori 3 kane perdorur me sukses internetin e ofruar nga Operatori 3 sic u theksua edhe me lart, me tarifa mjaft te uleta).

Operatori 3 gjykon se koston e larta te ketij sherbimi jane barrierat me te medha per zhvillimin me sukses te 3G vecanerisht per operatoret e rinj dhe me numer te ulet pajtimtaresh. Shteti duhet te mbeshtese ne kete proces operatoret e rinj, per te cilet eshte mjaft e veshtire te justifikojne koston e investimit ne infrastrukturen e rrjetit, dhe implementimit te ketij sherbimi ne te gjitha aspektet.

Bazuar ne kriteret e mesiperme, gjykojme se AKEP duhet te analizoje me kujdes vleren per dy licencat e tjera 3G, ne kuader te mbrojtjes se konkurrences efektive ne shtet dhe balancimit te perfitimeve mes shtetit, operatoreve dhe abonenteve ne kete proyes, gjate gjithë vazhdueshmerise se procesit.

Per sa me lart, Operatori 3 sugjeron se AKEP duhet te jape Autorizimin per perdorimin e frekuencave UMTS pa *pagese fillestare*, ne mbeshtetje te operatoreve te rinj, zhvillimit te konkurrences, zhvilimit te tregut te komunikimeve elektronike dhe ne mbrojtje te konsumatorit, per ti dhene atij mundesine e perdorimit te ketyre sherbimeve me nje ,cmim te arsyeshem.

Varesisht edhe konsideratave te AKEP dhe te autoriteteve te tjera me rol ne kete proces, Operatori 3 do te cmoje nese nje pagese fillestare ne nje vlere gjithsesi me e ulet se ajo e ofertuar nga operatoret ne tenderin per licencen e trete 3G mund te merret persiper.

Qendrimi i AKEP:

AKEP, duke vleresuar ecurine e deritanishme te procesit te dhenies se te drejtave te perdorimit ne brezat UMTS:

- **dhenien e dy autorizimeve te mëparshëm individual për përdorimin e frekuencave të brezit 1920.3-1935.3/2110.3-2125.3 MHz dhe 1900.0-1905.0 MHz sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.a. me vlere 31.400.000 Euro, dhe brezit 1935,3-1950,3 / 2125,3 – 2140,1 MHz dhe 1905-1910 MHz sipermarresit Albanian Mobile Communications Sh.a. me vlere 15.100.000 Euro, nëpërmjet zbatimit të procedurës së tenderit publik.**
- **Ofertat e paraqitura ne proceduren per dhenien e te drejtes se trete te perdorimit ne keto breza frekuencash**
- **gjendjen e tregut aktual te komunikimeve elektronike**

- **duke marre ne konsiderate edhe propozimet e ardhura ne kete keshillim publik**

do te propozoje nje cmim minimal te pranimit te ofertes me vlere prej 4.000.000 (katermilion) Euro.

OPERATORI 4

Ne vijim te konsultimit publik shpallur nga AKEP per dokumentin "Mbi dhenien ne perdorim te brezave te frekuencave UMTS 1900-1980 MHz dhe 2110-2170 MHz", te dates 30.05.2012 OPERATORI 4 deshiron fillimisht t'Ju shprehe vleresimin e tij per publikimin e ketij Dokumenti per keshillim me palet e interesuara.

OPERATORI 4, si nje aktoret e interesuar, bazuar ne aktet rregullatore ne fuqi e ne nenin 68, pika 2, te Ligjit Nr. 9918, dale 19.05.2008 "*Per Komunikimet Eleklronike ne Republikën e Shqiperise*" (me poshte "*Ligji nr. 9918*"), Ju parashlron komentet dhe qendrimin e tij mbi pyetjet e shkruara per konsultim si me poshte vijon:

Pyetja 1: A jeni dakort me kete ndarje te brezave? Po me sasine e spektrit per cdo te drejte perdorimi?

Koment: OPERATORI 4 eshte dakort me ndarjen e brezave, sepse Brezi ne dispozicion te ketij sherbimi eshte ndare ne menyre te barabarte per te gjithë (kater) te drejtat e mundshme.

OPERATORI 4 eshte dakort me sasine qe AKEP ka dedikuar per spektrin e ciftuar prej 3 kana te 5 MHz (FDD) per cdo te drejte autorizimi, sepse ky numer kanalesh do te jete i nevojshem per te ofruar nje sherbim cilesor persa i perket mbulimit dhe shmangies se inlerferencave, si edhe shpejlesise maksimale te transmetimit te te dhenave qe kjo teknologji ofron , e cila varet edhe nga numri i kanaleve te perdorura ne nje stacion. Ne praktikate boterore eshte perdorur teknologjia UMTS FDD dhe nje numer i tille kanalesh konsiderohet i nevojshem.

Operatori 4 komenton mbi pamundesine e perdorimit te njekohshem te teknologjise FDD dhe TDD, d.m.th. te brezit te ciftuar dhe brezit te paciftuar, per shkak te ndryshimeve ne teknologjine e nderfaqes ajrore dhe frekuencave te perdorura: aktualisht nuk jane zhvilluar pajisjet qe te suportojne dy standartet njekohesisht, prandaj operatoret nuk do ta shfrytezojne kete brez frekuencash prej 5MHz.

Per kete arsye sugjerojme:

Te mos jepet ky brez frekuencash per cdo te drejte autorizimi; ose

Te mos kete tarife vjetore per kete 5 MHz.

Ne aspektin financiar, keto frekuenca kane kosto te konsiderueshme shtese per operatoret, nderkohe qe operatoret nuk do te perfitojne perderisa keto frekuenca nuk do te perdoren/shfrytezohen.

Qendrimi i AKEP:

OPERATORI 4 eshte dakort me ndarjen e brezave dhe sasine e spektrit per cdo te drejte perdorimi te propozuar nga AKEP per teknologjine FDD. Sa i perket brezit prej 5 MHz (TDD) qe eshte pjese e spektrit te caktuar per tu dhene per cdo autorizim qellimi i AKEP eshte qe:

- **te mundesoje futjen e teknologjive te ndryshme duke respektuar keshtu kushtin e neutralitetit te teknologjise**

- per te siguruar nje shfrytezim sa me efektiv te spektrit te frekuencave.
- per te ruajtur barazine ne trajtimin e sipermarresve te tregut te komunikimeve elektronike
- te shfrytetoje eksperiencat me te mira europiane ne administrimin e spektrit.

Pyetja 2: Mendoni se do te jete me e pershtateshme te jepet nje e drejte perdorimi apo dy te drejta perdorimi ne te njejten kohe ? Ju lutemi komentin Tuaj.

Koment: Ne vijim edhe te qendrimeve te tij te meparshme, OPERATORI 4 ka mbeshtetur gjithmone idene dhe ka kerkuar liberalizimin e plote te sherbimit te 3G-se, qe do te sillte per rrjedhoje nje konkurrence te ndershme dhe me te madhe ne treg , duke i vendosur operatoret ne pozita dhe kushte te njejta "loje".

Ne lidhje me zhvillimet ne teknologji dhe tregun Shqiptar, OPERATORI 4 e konsideron dhenien e 2 licensave te tjera 3G si thelbesore per rritjen gjithashtu te cilesise se sherbimeve dhe ofrimit te cmimeve me te favorshme, ne perfitim te plote te konsumatoreve shqiptare.

OPERATORI 4 ka ndertuar dhe zhvilluar tashme rrjetin e vet ne menyre te tille qe te suportojte teknologjine 3G; sistemi perkates i tarifimit eshte konfiguruar te gjithe platformat per t'i ofruar klienteve ne nje kohe te shkurter pas licencimit, sherbimet e plota te 3G-se, dhe prandaj eshte i gatshem per implementimin te menjehershem te infrastruktures 3G.

OPERATORI 4 thekson edhe nje here se jo vetem eshte me e pershtateshme, por eshte e domosdoshme qe dy te drejtat e perdorimit te jepen ne te njejten kohe, pasi kjo do te nxise dhe rrise konkurrencen e ndershme, duke sjell si pasoje produkte me te mira, game me te gjere produktesh, penetrim me te larte te sherbimit 3G ne te gjithe territorin e vendit si dhe cmime me te favorshme per konsumatorin.

Qendrimi i AKEP:

AKEP eshte dakort me propozimin e Operatorit 4.

Pyetja 3: Cila eshte vlera qe jeni te gatshem te paguani per Autorizim sipas percaktimit te bere ne piken 1.2 te ketij dokumenti?

Koment: OPERATORI 4 e ka shprehur edhe me pare mendimin e vet se konsideron qe barrierat per hyrjen ne treg duhet te jene ne raport te drejte me cmimet e mundshme fundore te ketij sherbimi dhe vlera e nje Autorizimi te tille duhet te jete ne pershtatje me kushtet aktuale te tregut te telefonise se levizshme.

Operaloret e medhenj dhe te fuqishem financiarisht kane marre perfitime nga Autorizimet e marra, ndersa operaloret e rinj dhe me te vegjel jane akoma duke u pergatitur per Autorizimin e 3G dhe cdo dite vonese ne dhenien e Autorizimit demton OPERATORIN 4 dhe konkurrencen e ndershme.

Per OPERATORI 4 si vlera e Aulorizimit do te ishte e arsyeshme jo me shume se 2-2.5 milion Euro. Vetem ne kete menyre OPERATORI 4 mund te kete mundesi te investoje ne rrjet dhe te zhvilloje sherbime te reja, per te patur mundesi qe te konkurrojme krahas operaloreve te medhenj.

Qendrimi i AKEP:

AKEP, duke vleresuar ecurine e deritanishme te procesit te dhenies se te drejtave te perdorimit ne brezat UMTS:

- dhenien e dy autorizimeve te mëparshëm individual për përdorimin e frekuencave të brezit 1920.3-1935.3/2110.3-2125.3 MHz dhe 1900.0-1905.0 MHz sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.a. me vlere 31.400.000 Euro, dhe brezit 1935,3-1950,/ 2125,3 – 2140,1 MHz dhe 1905-1910 MHz sipërmarrësit Albanian Mobile Communications Sh.a. me vlere 15.100.000 Euro, nëpërmjet zbatimit të procedurës së tenderit publik.
- Ofertat e paraqitura në procedurën për dhenien e të drejtës së tretë të përdorimit në këto breza frekuencash
- gjendjen e tregut aktual të komunikimeve elektronike
- duke marrë në konsideratë edhe propozimet e ardhura në këtë keshillim publik

do të propozojë një çmim minimal të pranimit të ofertës me vlerë prej 4.000.000 (katërmilion) Euro.

5. A ka ndonjë çështje tjetër për tu marrë në konsideratë në këtë proces?

Koment: Se pari, për OPERATORI 4 marrja e autorizimit 3G është një mundësi për të konkurruar me një hap me operatorët me të vjetër në treg. Por, OPERATORI 4 dëshiron të theksojë se pagesa e lartë e Autorizimit është një barrierë për një operator të ri, që është akoma në hapat e para të zhvillimit dhe investimit, prandaj do të sugjerojmë marrjen në konsideratë të AKEP të një pagese me të perballueshme. Gjithashtu, të mos harrojmë se kostoja e Autorizimit ndikon në ofrimin e çmimeve konkurruese për tregun konsumator të shërbimeve 3G.

Se dyti, OPERATORI 4 sugjeron që në dhenien e dy të drejtave të tjera të përdorimit nga AKEP, duhet patjetër të kufizohet pjesëmarrja në tender të operatorëve që janë autorizuar tashmë për shërbimet 3G, pasi është një kriter që ndikon drejtëpërdrejt në konkurrencën e ndershme në tregun e shërbimeve të telefonisë së levizshme. AKEP në tenderin e shpallur në Janar të këtij viti, kishte përcaktuar se *"ishin të përjashtuar nga procedura e tenderit sipërmarrësit e autorizuar për të përdorur bandën e frekuencave UMTS, si dhe partnerët e tyre të"*, por në këtë dokument nuk përmendet një fakt i tillë.

Nisur edhe nga VKM nr. 1252, datë 10.9.2008, "Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhenien e së drejtës së përdorimit të frekuencave", i ndryshuar, (i cili është një nga dokumentat bazë për procedurat e tenderimit), ku parashikohet një kufizim i tillë për operatorët e autorizuar për bandat GSM, OPERATORI 4 konsideron se në paralelizëm me GSM, edhe për tenderin e frekuencave UMTS duhet të vendoset i njëjti kufizim.

Theksojmë edhe njëherë se një kufizim i tillë është kriter shumë i rëndësishëm që siguron konkurrencë të efektive në treg, siguron mosdiskriminim dhe barazi në trajtimin e ofruesve të rrjeteve të levizshme dhe plotëson një objektivi rregullator si nxitja e përdorimit të frytshëm të frekuencave.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP e vlerëson komentin e Operatorit 4, por lidhur me këtë çështje AKEP do të shprehë në hapat e mëvonshëm të procesit.